

KONTRATE SHIT-BLERJE

Kuotave te shoqërisë “GJERGJI-ELEKTRO INDUSTRIALE”

Baza Ligjore
Nenet 6, 705-750 te Kodit Civil

Në Tiranë, sot më 04.07.2025 (dymijë e njezete e pese), palet:

SHITESI: Z. FADI AL HUSSAIN, lindur me 28.11.1980, ne Siri, shtetas Sirian, mbajtes i pasaportes me nr N014166844, madhor e me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

BLERESI: Z. OSAMA SAID, shtetas Sirian, i datëlindjes 15.03.1968, identifikuar me ane te pasaportës siriane me numër P000403487, madhor e me zotësi te plota juridikë për te vepruar.

Palët, me vullnetin e tyre te lire, te plote dhe ne mirëkuptim te ndërsjelle, nenshkruajn kete kontrate, ne kushtet dhe me te dhënat e mëposhtme:

TE DHENA PARAPRAKE

- I. Shitësi është ortak i 15% te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqërisë me Pergjegjesi te Kufizuar “GJERGJI-ELEKTRO INDUSTRIALE” me NIPT M57603505T, themeluar dhe regjistruar me date 03/02/2025, me seli ne adresën: Lezhe, lagjia Beslidhja, Rruga “Shtraus”, Nesi Sherbimi ne zonen kadastrale nr.8632, numri pasurise 4/186-N3, kati I-re.
- II. Shoqëria “GJERGJI-ELEKTRO INDUSTRIALE” me vendimin nr. 4, date 04.07.2025 te Asamblesë se Përgjithshme te Ortakeve kane dhëne pëlqimin për shitjen 15 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqërisë “GJERGJI-ELEKTRO INDUSTRIALE”, nga totali i kuotave prej 15% te ortakut **Z. FADI AL HUSSAIN, ne cilësinë e shitësit, tek blerësi, përkatësisht: Z. OSAMA SAID.**
- III. Mbi kuotat e kapitalit themeltar te shoqërisë “GJERGJI-ELEKTRO INDUSTRIALE”, nuk ka asnjë barre sigurorese.

NENI 1

Objekti

Objekti i kësaj kontrate është shitja e pasurisë se luajtshme sipas kuotave te përcaktuara me poshtë, te kapitalit themeltar te shoqërisë “GJERGJI-ELEKTRO INDUSTRIALE”, nga shitësi ne favor te palës blerëse.

- **Z. FADI AL HUSSAIN**, shet 15% nga pjesa e vet prej 15% te kuotave me vlere nominale 15 000 (pesëmbëdhjete mije) lek.

NENI 2

Çmimi

2.1 Shitësi ia shet këtë pasuri blerësit kundrejt një çmimi dhe përkatësisht :

- **Z. FADI AL HUSSAIN**. shet 15% nga pjesa e vet takuese prej 15% te kuotave te shoqërisë “GJERGJI-ELEKTRO INDUSTRIALE” me vlere nominale 15 000 (pesëmbëdhjete mije) lek, te cilat i blen **Z.OSAMA SAID**.



2.2. Palët deklarojnë se çmimi është paguar nga blerësi në favor të shitësit, i cili nuk kane asnjë pretendim.

2.3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitje kuotash dhe regjistrimin e saj në QKB:

- **Z. FADI AL HUSSAIN** largohet si ortak i Shoqërisë “GJERGJI-ELEKTRO INDUSTRIALE” ndërsa;
- **Z. OSAMA SAID** behet ortak i shoqërisë me 15% të kuotave të shoqërisë “GJERGJI-ELEKTRO INDUSTRIALE” me një vlerë nominale prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lek,

NENI 3

Te drejtat dhe detyrimi i palëve

- 3.1 Shitësi garanton blerësin për titullin e pronësisë të pasurisë objekt kontrate dhe saktësinë e dokumentacionit zyrtar të saj, në të kundërt mban përgjegjësi civile për demin e shkaktuar.
- 3.2 Shitësi është i detyruar të dorëzojë pasurinë objekt kontrate me gjithë dokumentacionin përkatës blerësit, me marrjen e pagesës nga ky i fundit.
- 3.3 Shitësi është i detyruar të dorëzojë pasurinë objekt kontrate blerësit të shkarkuar nga çdo e drejtë apo pretendim i të tretëve.
- 3.4 Blerësi ka detyrim të njoftojë brenda 5 ditëve shitësin në rast se të trete ngrëne pretendime pronësie mbi sendin objekt kontrate.

NENI 4

Kalimi i pronësisë

Me nënshkrimin e kontratës, shitësi **FADI AL HUSSAIN** zhvishet plotësisht nga pronësia mbi 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të kuotave si me sipër dhe ajo i kalon e plote blerësit. Bleres:

- **Z. OSAMA SAID**, behet zotërues i 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë “GJERGJI-ELEKTRO INDUSTRIALE”, të përfituara nga shitësi **FADI AL HUSSAIN**, duke u bërë kështu ortak me 15% të kuotave të shoqërisë:

NENI 5

Te ndryshme

- 5.1 Palët u porositen që të depozitojnë këtë kontratë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 5.2 Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin për shkak të ekzekutimit të kësaj kontrate. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre ehte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata iu lexohet të paleve të cilët e kuptojnë, pranojnë përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruajnë atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin.

Kontrata redaktohet në 4 kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike.

SHITESI

FADI AL HUSSAIN

FADI AL HUSSAIN 


BLERESIT

OSAMA SAID


